



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Gjykata Kushtetuese / Ustavni sud / Constitutional Court
Adresa: Perandori Justinian, PN. Prishtinë
T: +381 (0)38 220 104; F: +381 (0)38 220 112; www.gjk-ks.org

Prishtinë, më 23 qershor 2010
Nr. Ref.: RK 31/10

VENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. Kl. 16/09

Sami Sekiraqa

kundër

Vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës S.C.Ap. nr. 448/2006 dhe
Vendimit të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës D.C.P. nr. 521/2005

GJYKATA KUSHTUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Kadri Kryeziu, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare, dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Njëzëri miraton këtë vendim për papranueshmëri

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Sami Sekiraqa. Ai jeton në Prishtinë.

Vendimet e sfiduara

2. Vendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës S.C.Ap. nr. 448/2006, i 12 dhjetorit 2006, dhe Vendimi i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës D.C.P. nr. 521/2005, i 1 janarit 2006.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës pohon se i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 (e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm) dhe nenin 32 (e drejta për mjete juridike) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Ai pohon që (1) ishte gjykuar në mungesë; (2) provat nuk e mbështesin dënimin e tij dhe se ai ishte ndjekur penalisht pasi ideologjia e tij politike dallonte nga ideologjia e partisë politike në pushtet, Partisë Komuniste.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme Kushtetuta); neni 20 i Ligjit nr. 03/L-121 mbi Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme Ligji); dhe neni 54(b) i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme Rregullorja e punës).

Përmbledhje e procedurës para Gjykatës Kushtetuese

5. Më 30 prill 2009, parashtruesi e parashtroi kërkesën e vet në Gjykatën Kushtetuese. Më 4 maj 2009, Sekretaria e Përkohshme e Gjykatës Kushtetuese e njoftoi parashtruesin se Gjykata do ta shqyrtonte kërkesën e tij pasi Gjykata të bëhej tërësisht funksionale.
6. Më 18 dhjetor 2009, Gjykata Kushtetuese ia dërgoi një letër Gjykatës Supreme të Kosovës, me të cilën kërkonte përgjigje në lidhje me këtë kërkesë.
7. Më 23 dhjetor 2009, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës e regjistroi përgjigjen e vet, Vendimi Ap. Nr. 448/06, që përfshinte arsyetimin dhe sqarimin e Gjykatës, si dhe vendimin publik që ua kishte dhënë palëve.
8. Më 26 janar 2010, Kryetari e caktoi Gjyqtarin Altay Suroy Gjyqtar Raportues.
9. Më 13 maj 2010, Kolegji Shqyrtues, i përbërë nga Kadri Kryeziu (kryesues), Gjyljeta Mushkolaj dhe Almiro Rodriguez, e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit Suroy dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë ta hidhte rastin poshtë si të papranueshëm.

Faktet

10. Më 1 qershor 2006, parashtruesi, Sami Sekiraqa, u shpall fajtor nga Gjykata e Qarkut e Prishtinës për veprën penale të mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve sipas neni 328 të Kodit Penal të Kosovës. Gjykata shqiptoi një dënim prej 11 muaj burg, dhe shtyu ekzekutimin e tij me një dënim me kusht prej dy vjetësh me kusht që z. Sekiraqa të mos kryente asnjë vepër tjetër penale gjatë kësaj periudhe dyvjeçare. (D.C.P. Nr. 521/2005, i 01.06.2006).
11. Prokurori publik i qarkut të Prishtinës parashtroi ankesë për sanksion penal në Gjykatën Supreme të Kosovës më 18 gusht 2006.
12. Avokati i parashtruesit parashtroi ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës.
13. Më 12 dhjetor 2006, Gjykata Supreme e Kosovës i hodhi poshtë ankesat si të papranueshme sepse palët hoqën dorë nga e drejta për t'u ankuar brenda afatit të paraparë ligjor. Gjykata e shkallës së parë i njoftoi palët për të drejtën e tyre në ankesë dhe për detyrimin e tyre për ta parashtruar ankesën brenda tetë ditësh pas

vendimit të Gjykatës, në përputhje me nenin 394, paragrafët 1 dhe 3, të Kodit të Procedurës Penale (S.C. Ap. Nr. 448/2006 i 12.12.2006). Sipas nenit 400, paragrafit 2 të Kodit të Procedurës Penale, kur personi me të drejtë ankese dështon ta parashtrojë ankesën brenda afatit të paraparë ligjor, konsiderohet se ai/ajo ka hequr dorë nga e drejta në ankesë.

14. Më 18 dhjetor 2008, Gjykata e Qarkut e Prishtinës e mbështeti kërkesën e parashtruesit për ta hequr emrin e tij nga regjistri i dënimeve. (D.C.P Nr. 215/2008, i 18.12.2008 (i korigjuar nga D.C.P. Nr. 215/2008, i 22.12.2008).

Vlerësimi i pranueshmërisë të kërkesës

15. Parashtruesi thekson se neni 31 (e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm) dhe neni 32 (e drejta për mjete juridike) të Kushtetutës janë bazë për kërkesën e tij.
16. Neni 113.7 i Kushtetutës thotë:
Individët janë të autorizuar të ngrenë shkëljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.
17. Neni 48 i Ligjit mbi Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës thotë:
Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë.
18. Sipas Kushtetutës, nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të veprojë si gjykatë e apelit, apo gjykatë e shkallës së katërt, me rastin e shqyrtimit të vendimeve të nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
19. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse dëshmitë janë paraqitur në mënyrë të tillë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë sa që parashtruesi ka pasur gjykim të drejtë (shih ndër autoritete të tjera, Raportin e Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, App. Nr. 13071/87, të miratuar më 10 korrik 1991).
20. Pohimi i parashtruesit se ishte gjykuar në mungesë është i pabazë. Z. Sekiraqa ishte i pranishëm, bashkë me avokatit e tij, në seancën kryesore në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës më 1 qershor 2010. Përveç kësaj, pohimi i parashtruesit se dënimi i tij nuk mbështetet në prova është i pabazë. Parashtruesit dhe avokatit të tij iu ofruan mundësi të shumta për ta theksuar rastin e z. Sekiraqa dhe për ta kontestuar zbatimin e ligjit lidhur me provat para Gjykatës së Qarkut të Prishtinës dhe Gjykatës Supreme të Kosovës. Pas ekzaminimit të procedurave si tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk gjen që procedurat ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo të prekura nga arbitrariteti (shih *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së mbi pranueshmërinë e kërkesës nr. 17064/06, të 30 qershorit 2009).
21. Për më tepër, parashtruesi nuk ka dorëzuar ndonjë dëshmi *prima facie* që tregon shkëljen e të drejtave të tij sipas Kushtetutës (shih Vanek kundër Republikës Sllovaqe, Vendimi i GJEDNJ-së mbi pranueshmërinë e kërkesës nr. 53363/99, të 31 majit 2005). Parashtruesi nuk thekson si nenet 31 dhe 32 e mbështesin ankesën e tij, siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 48 të Ligjit.

22. Prandaj, kjo kërkesë është e pabazë dhe duhet të hidhet poshtë.

PËR KËTO ARSYE


Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 20 të Ligjit, dhe nenin 54(b) të Rregullores së punës, njëzëri,

VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme.
- II. Sekretaria do t'i njoftojë palët me këtë vendim dhe do ta publikojë atë në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit.
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Altay Suroy



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani

